



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2024:004490

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05458640

P.nr.04/2024

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sadri Krasniqi, me bashkëpunëtor profesional Ali Kryeziu, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në çështjen penale kundër të pandehurit, V. A. nga, për shkak të veprës penale: lëndim i leht trupor nga neni 185, paragrafi 1, nën para. 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1798/2023, të datës 29.12.2023 dhe Marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.50/23, të datës 29.12.2023, më datë 15.03.2024, hartoi këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.03/24, e datës 08.03.2024, e lidhur ndërmjet të dëmtuarit S. Gj. dhe të pandehurit V.A. që të dy nga fsh., përkitazi me Aktakuzën PP.II.nr.1798/2023, të datës 29.12.2023.

II. H U D H E T aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1798/2023, të datës 29.12.2023, dhe

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit V. A. për shkak të veprës penale: lëndim i leht trupor nga neni 185, paragrafi 1, nën para. 1.4 të KPRK-së, *pasi që në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.*

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.nr.1798/2023, të datës 29.12.2023, ka propozuar që ndaj të pandehurit, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: lëndim i leht trupor nga neni 185, paragrafi 1, nën para .1.4 të KPRK-së, të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtimin fillestar kundër të pandehurit për datë 06.03.2024, në fillim të kësaj seance, i pandehuri i propozon gjykatës që seanca gjyqësore të shtyhet për kohë të pacaktuar dhe kjo çështje penale ndaj tij të dërgohet për zgjidhje me procedurë të ndërmjetësimit, të cilin propozim nuk e kundërshton prokurorja e shtetit.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të pandehurit, më datën 06.03.2024, lëndën i ka dërguar për procedurë të mëtutjeshme Referentit për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë.

Referenti për ndërmjetësim më dat.08.03.2024, e njofton Gjykatën se lidhur më çështjen penale P.nr.04/2024, më 08.03.2024, pranë kësaj Gjykate, në procedurën e ndërmjetësimit është lidhur Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.03/24, në mes të pandehurit V. A. dhe të dëmtuarit S. Gj..

Gjykata, pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se në këtë çështje penale duhet hedhur aktakuzën e lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, si dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurit V. A. nga, ngase më datë 08.03.2024 në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, e duke u bazuar në nenin 229, paragrafi 4, të Kodit të Procedurës Penale, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**

2024:004490, 15.03.2024

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi, d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.